

## ABSTRAKT

Krimi i organizuar është një formë e veprimtarisë së paligjshme që karakterizohet nga një strukturë e koordinuar dhe hierarkike e individëve ose grupeve që synojnë përfitimin financiar përmes veprimtarive të ndaluara me ligji si tregtia me drogë dhe armë, trafikimi me njerëz, prostitucioni shpëlarja e parave etj. Meqenese kjo formë e kriminalitetit është e pranishme në të gjitha shtetet bashkëkohore, janë miratuar instrumente ndërkombëtare për të parandaluar dhe luftuar ate.

Përvec në nivel ndërkombëtar edhe në nivel nacional shtetet kanë përgaditur infrastrukturën ligjore për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar.

Në Republikën e Kosovës, për të adresuar krimin e organizuar, janë ndërmarrë masa ligjore dhe strategjike. Kjo përfshin Kodin Penal , Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit , Ligji për parandalimin e pastrimit të parave së parave dhe financimit të terrorizmit etj. Po ashtu, janë miratuar edhe strategji kombëtare si Strategjia shtetërore për luftën kundër kriminalitetit të organizuar, Strategjia kombëtare kundër terrorizmit dhe Strategjia dhe plani për ndalimin e trafikimit me persona.

Qëllimi i këtij hulumtimi është analimi legjislativ kosovar përkitazi me krimin e organizuar dhe zbatimin e tij nga gjykatat në Kosovë konkretisht në politikën ndëshkimore që këto gjykata kanë aplikuar ndaj kryesve të krimit të organizuar. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda kualitative (deskriptive). Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i legjislativ përkitazi me krimin e organizuar dhe të dhënat nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për periudhën 2017-2020. Poashtu edhe mostra prej 50 lendeve në Gjykatën Themelore në Prishtinë është përdorur për të analizuar disa karakteristika personale të kryesve të dënuar për krim të organizuar nga kjo gjykatë.

**Fjalët kyçe:** *krim i organizuar, legjislacion, politike ndëshkimore, gjykata.*